



Në mbështetje të nenit 26, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe të nenit 61, paragrafi 10 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen e mbajtur me datë 14.07.2023, miraton:

UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr. 03/2023
MBI KRITERET PËR SHQIPTIMIN E GJOBAVE

Neni 1
Qëllimi

1. Ky Udhëzim Administrativ (në tekstin e mëtejme – Udhëzimi) përcakton kriteret të cilat Autoriteti i Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Autoriteti), duhet të marrë parasysh kur vendosë gjoba ndaj ndërmarrjeve për shkeljet e specifikuar në nenin 57 dhe nenin 58 të Ligjit Nr.08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Ligji).
2. Qëllimi i gjobave të referuara në paragrafin (1) të këtij neni, është që të dënojë (sanksionojë) kryerësit e shkeljes të Ligjit, të eliminojë efektet e dëmshme të shkeljes së Ligjit, të dekurajojë ndërmarrjet e tjera që të mos shkelin dispozitat e Ligjit dhe të sigurojë konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ përkufizohen si në vijim:
 - a) **Ndërmarrje** - nënkupton ndërmarrje e përkufizuar në nenin 3 paragrafi 10 të Ligjit.
 - b) **Gjoba** - masa që i shqiptohet ndaj një ndërmarrjeje, ose grup i ndërmarrjeve nga Autoriteti për shkeljet e specifikuar në nenet 57 dhe 58 të Ligjit.
 - c) **Të hyra** - të ardhurat nga shitja e mallrave dhe/ose shërbimeve që ndërmarrja ka realizuar në tregun përkatës në të cilin është konstatuar shkelja e Ligjit.

- d) **Grup ndërmarrjesh** - grup subjektësh që përbëhet nga një organizim unitar i elementeve personale, të prekshme dhe të paprekshme, i cili ndjek një qëllim të caktuar ekonomik mbi një bazë afatgjatë dhe që mund të kontribuojë në kryerjen e shkeljes së ligjit.
 - e) **Qarkullimi i përgjithshëm** - të hyrat e përgjithshme të realizuara nga ndërmarrja ose grupi i ndërmarrjeve në të gjitha vendet e botës (mbarë botën).
 - f) **Marrëveshjet e ndaluara (kartelet)** - nënkupton një marrëveshje ose praktikë të bashkërenduar ndërmjet dy ose më shumë konkurrentëve që synon të koordinojë sjelljen e tyre konkurruese në treg ose të ndikojë në parametrat përkatës të konkurrencës me anë të praktikave të tilla si, por pa u kufizuar në, fiksimin ose koordinimin e çmimeve të blerjes ose shitjes ose të kushteve të tjera tregtare, duke përfshirë në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale, shpërndarjen e kuotave të prodhimit ose shitjes, ndarjen e tregjeve dhe klientëve, duke përfshirë manipulimin me oferta, kufizimet e importeve ose eksporteve ose veprimet anti-konkurruese kundër konkurrentëve të tjerë.
 - g) **Pasardhës ligjor** - ndërmarrja që merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e një ndërmarrje tjetër, pas blerjes së aksioneve të saj ose në ndonjë mënyrë tjetër.
 - h) **Pasardhës ekonomik** - ndërmarrja e cila do të përgjigjet për shkeljen e kryer në të kaluarën nga një ndërmarrje tjetër, sepse ka vazhduar veprimtarinë ekonomike të kryesit dhe ndërmjet këtyre dy ndërmarrjeve ka një vazhdimësi ekonomike.
3. Shprehjet e tjera të përdorura në Udhëzim korrespondojnë me përkufizimet e përdorura në Ligj.

Neni 3

Metodologjia për llogaritjen e gjobave

1. Me rastin e shqiptimit të gjobave, Autoriteti, në pajtim me nenin 61, paragrafin 2 të Ligjit aplikon metodologjinë me dy faza për llogaritjen e gjobave për secilën ndërmarrje që është vërtetuar se ka bërë shkelje të Ligjit.
2. Në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, Autoriteti llogaritë shumën bazë të gjobës që konsiderohet si faza e parë e llogaritjes së saj.
3. Shumën bazë të gjobës të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, Autoriteti mund ta zvogëlojë ose rritë, varësisht nga rrethanat lehtësuese ose rënduese në procedurë. Zvogëlimi apo rritja e gjobës konsiderohet si faza e dytë e llogaritjes së gjobës.

Neni 4

Elementet e llogaritjes së shumës bazë të gjobës

1. Shuma bazë e gjobës do të ndërlidhet me një pjesë të të ardhurave të ndërmarrjes, në varësi të shkallës së rëndësisë së shkeljes së Ligjit dhe kohëzgjatjes së shkeljes.

2. Autoriteti është i detyruar që ta përcaktojë rëndësinë e shkeljes së Ligjit në baza, rast pas rasti, duke marrë parasysh të gjitha faktet relevante dhe rrethanat e rastit konkret.
3. Për të llogaritur shumën bazë të masës ndëshkuese administrative nga paragrafi 1 i këtij neni, Autoriteti do të vendosë shumëfishin e shumës së 100.00 (njëqind) Euro.

Neni 5

Llogaritja e të hyrave të ndërmarrjes

1. Llogaritja e të hyrave, siç përcaktohet në nenin 2, paragrafi 1 nën paragrafi c të këtij udhëzimi, merren shitjet e bëra nga ndërmarrja gjatë vitit të fundit të plotë afarist në të cilin ndërmarrja ka marrë pjesë në shkeljen e ligjit. Autoriteti nuk do të llogarisë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSh) të shitjeve, as taksa të tjera që lidhen drejtpërdrejt me shitjen.
2. Nëse shkelja e ligjit nga shoqata e ndërmarrjeve ka të bëjë me aktivitetet e anëtarëve të saj, Autoriteti me rastin e caktimit të gjobës, sipas nenit 4 të udhëzimit dhe paragrafit 1, të këtij neni, do të konsiderojë se të ardhurat e përcaktuara në nenin 2, paragrafi 1, nën paragrafi c, të këtij udhëzimi, korrespondojnë me shumën e të ardhurave të të gjithë anëtarëve të shoqatës.
3. Të dhënat për të hyrat, Autoritetit detyrimisht do t'ia paraqesë ndërmarrja e cila është vërtetuar se ka shkelur Ligjin. Nëse Autoriteti konsideron se të dhënat e paraqitura nuk janë të plota ose janë të pasakta, Autoriteti, informatat relevante për të hyrat e ndërmarrjes do t'i përcaktojë në bazë të nenit 39, paragrafi 7 të Ligjit, respektivisht të hyrat e ndërmarrjes do t'i përcaktojë në bazë të të dhënave të pjesshme të mbledhura ose në bazë të çdo informacioni tjetër që e konsideron të përshtatshëm.

Neni 6

Përcaktimi i shumës bazë të gjobës

1. Shuma bazë e gjobës do të ndërlidhet me një pjesë të të ardhurave, siç përcaktohet në nenin 2, paragrafi 1, nën-paragrafi c, të këtij udhëzimi, në varësi të shkallës së rëndësisë së shkeljes së ligjit, shumëzuar me numrin e viteve të shkeljes.
2. Përqindja e të hyrave të përdorura me rastin e llogaritjes së gjobës sipas paragrafit 1. të këtij neni, caktohet në masën deri në tridhjetë për qind (30%) të të hyrave. Autoriteti, në përputhje me nenin 4, paragrafi 2, të këtij udhëzimi, në secilin rast veç e veç e përcakton shkallën e rëndësisë të shkeljes së Ligjit.
3. Për të vendosur nëse pjesa e të hyrave që do të merret në konsideratë në një rast të caktuar, duhet të jetë në skajin e poshtëm apo në skajin e sipërm të shkallës, Autoriteti do të ketë parasysh një sërë faktorësh, si për shembull natyrën e shkeljes, pjesëmarrja (pjesët) e përbashkët në treg e të gjitha ndërmarrjeve në fjalë, shtrirja gjeografike e shkeljes, si dhe nëse shkelja është zbatuar apo jo.

4. Me rastin e llogaritjes së kohëzgjatjes së shkeljes sipas paragrafit 1. të këtij neni, periudhat më të vogla se 6 (gjashtë) muaj do të llogariten si gjysmë viti; periudhat më të gjata se 6 (gjashtë) muaj por më të shkurtra se një vit do të llogariten si vit i plotë.
5. Kartelet siç janë të përkufizuara në nenin 2, paragrafi 1, nën-paragrafi (f) të këtij udhëzimi, të cilat zakonisht janë sekrete, për nga vet natyra e tyre, janë në mesin e kufizimeve më të dëmshme të konkurrencës, prandaj pjesa e të hyrave të marra parasysht për shkelje të tilla, sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, zakonisht do të caktohet në skajin e sipërm të shkallës.

Neni 7

Rritja e shumës bazë të gjobës për kartelet apo shkelje të tjera të rënda të ligjit

1. Pavarësisht nga kohëzgjatja e pjesëmarrjes së ndërmarrjes në shkeljen e ligjit, në rastet e karteleve Autoriteti do të përfshijë në shumën bazë të gjobës një shumë prej pesëmbëdhjetë për qind (15%) deri në njëzetepesë për qind (25%) të vlerës së të hyrave, siç specifikohet në nenin 5 të këtij udhëzimi.
2. Qëllimi i rritjes së gjobës me shumën shtesë të sipërpërmendur në paragrafin 1 të këtij neni është për të penguar - dekurajuar ndërmarrjet e tjera për të hyrë në kartelet, si format më të rënda të shkeljes së ligjit.
3. Autoriteti mund ta aplikojë rritjen e shumës bazë të gjobës sipas paragrafit 1 të këtij neni, edhe në raste të tjera të shkeljes së ligjit, nëse shkeljet e tilla kufizojnë konsiderueshëm konkurrencën.
4. Autoriteti, kur vendosë për nivelin e rritjes së gjobës sipas paragrafi 1 të këtij neni në një rast të caktuar, do të ketë parasysht një sërë faktorësh, veçanërisht ata të përcaktuar në nenin 6, pika 3, të këtij udhëzimi.

Neni 8

Saktësimet në shumën bazë

Në llogaritjen e gjobës, Autoriteti mund të marrë parasysht rrethanat që rezultojnë në një rritje, ose ulje të shumës bazë siç përcaktohet në Fazën II. Ai do ta bëjë këtë në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm, i cili merr parasysht të gjitha rrethanat përkatëse siç përkufizohen më poshtë.

Neni 9

Rrethanat lehtësuese

1. Shumën bazë të gjobës të llogaritur sipas neneve 4,5,6 dhe 7 të këtij Udhëzimi, Autoriteti do ta zvogëlojë nëse vërteton ekzistencën e rrethanave lehtësuese.
2. Si rrethana lehtësuese do të konsiderohen si në vijim:

- a. Me përjashtim të pjesëmarrësve në marrëveshjen e ndaluar, ndërmarrja paraqet dëshmi për pushimin e veprimit të kundërligjshëm pasi të jetë njoftuar për fillimin e procedurës.
 - b. Dorëzimi i provave në Autoritet nga ndërmarrja që shkelja është pasojë e neglizhencës.
 - c. Dorëzimi i provave në Autoritet nga ndërmarrja se si ai, edhe pse ka marrë pjesë në marrëveshje të ndaluar, nuk e ka zbatuar këtë marrëveshje, por ka vepruar në përputhje me rregullat e konkurrencës.
 - d. Bashkëpunimi i ndërmarrjes me Autoritetin tejkalon detyrimin e ndërmarrjes për përjashtimin nga gjoba ose uljen e gjobës, sipas nenit 62 të ligjit.
3. Autoriteti nuk do ta marrë parasysh si rrethanë lehtësuese sipas paragrafit 2 të këtij neni, kohëzgjatjen më të shkurtër të shkeljes së ndërmarrjes individuale, sepse kohëzgjatja e shkeljes është një prej elementeve të fazës së parë të llogaritjes së gjobës në pajtim me nenin 4 paragrafi 1 të këtij Udhëzimi.

Neni 10 **Rrethana rënduese**

1. Shumën bazë të gjobës, llogaritur në përputhje me nenet 4,5,6 dhe 7 të këtij Udhëzimi, Autoriteti do ta rrisë, nëse vërteton ekzistencën e rrethanave rënduese.
2. Si rrethana rënduese konsiderohen si në vijim:
 - a. Ndërmarrja e vazhdon ose e përsërit të njëjtën shkelje, ose një të ngjashme, edhe pasi të jetë dorëzuar vendimi i Autoritetit për vërtetimin e shkeljes së ligjit.
 - b. Refuzimi për të bashkëpunuar me Autoritetin gjatë procedurës.
 - c. Pengimi i Autoritetit në punën e tij gjatë procedurës.
 - d. Roli i iniciatorit ose nxitësit të ndërmarrjeve tjera në shkeljen e ligjit.
 - e. Të gjitha veprimet dhe aktivitetet e ndërmarrja për të siguruar pjesëmarrjen e ndërmarrjeve tjera në shkeljen e ligjit.
3. Në rast të vazhdimit, ose përsëritjes së veprimeve të kundërligjshme të njëjta apo të ngjashme siç specifikohet në paragrafin 2 (a) dhe (b) të këtij neni, shumën bazë të gjobës, Autoriteti do ta rrisë me njëqind për qind (100%) për shkeljen e tillë të vërtetuar.

Neni 11
Rritja e gjobës për të arritur një efekt parandalues

1. Që gjoba të ketë efektin parandalues sipas nenit 1, paragrafi 2, të këtij udhëzimi, respektivisht të pengojë ndërmarrjen, e cila ka shkelur ligjin, si dhe të gjitha ndërmarrjet e tjera nga shkelja e dispozitave të Ligjit, Autoriteti mund, pavarësisht nga të hyrat të cilat ndërmarrja i realizon në tregun përkatës në të cilin është vërtetuar shkelja e ligjit, ta rrisë gjobën nëse ndërmarrja ka qarkullim veçanërisht të lartë në tregje tjera përkatëse.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Autoriteti mund ta rrisë shumën e gjobës të llogaritur sipas dispozitave të mësipërme të Udhëzimit me qëllim që të tejkalohet shuma e fitimeve të bëra padrejtësisht si rezultat i shkeljes së Ligjit, aty ku është e mundur që ajo shumë të vlerësohet.

Neni 12
Shuma maksimale e gjobës

1. Në bazë të paragrafit 1 të nenit 61 të ligjit, shuma maksimale e gjobës së shqiptuar sipas këtij udhëzimi nuk mund të kalojë dhjetë për qind (10%) të qarkullimit total që ndërmarrja ose grupi i ndërmarrjeve ka realizuar në mbarë botën gjatë vitit të fundit për të cilin është përfunduar raporti financiar.
2. Nëse ndërmarrja që ka shkelur ligjin i përket grupit të ndërmarrjeve, shuma maksimale e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni do të llogaritet nga qarkullimi i përgjithshëm i të gjithë grupit të tillë të ndërmarrjeve.

Neni 13
Paaftësia për të paguar

1. Në raste të jashtëzakonshme, me kërkesë të ndërmarrjes që është në një situatë të vështirë financiare dhe nuk është në gjendje të paguajë gjobën të përcaktuar me Ligj, si dhe duke marrë parasysh kriteret në këtë udhëzim, Autoriteti mund të bëjë ulje shtesë në shumën e gjobës.
2. Fakti që një ndërmarrje është në gjendje të vështirë financiare nuk është në vetvete arsye për zvogëlimin e gjobës.
3. Në raste të jashtëzakonshme sipas paragrafit 1 të këtij neni, Autoriteti mund ta ulë gjobën për një ndërmarrje, e cila së bashku me kërkesën për uljen e gjobës, i siguron Autoritetit prova objektive se shuma e vendosur e gjobës së specifikuar me Ligj dhe në përputhje me kriteret e këtij udhëzimi, do ta dëmtonte në mënyrë të pakthyeshme stabilitetin ekonomik të ndërmarrjes dhe vlerën e aseteve të saj.

Neni 14

Gjoha simbolike

1. Në raste të jashtëzakonshme, Autoriteti mund të shqiptojë gjoha simbolike.
2. Gjohën simbolike të specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni, Autoriteti mund t'ia shqiptojë një ndërmarrjeje sipas nenit 13 të këtij udhëzimi, si dhe në raste të tjera në të cilat Autoriteti ka konstatuar se shtrembërimi i konkurrencës nuk ishte domethënës, respektivisht nuk ka pasur ndikim të rëndësishëm negativ në treg.
3. Në rastet e specifikuara në paragrafin 2 të këtij neni, Autoriteti në mënyrë specifike do të theksojë arsyen për shqiptimin e gjohës simbolike.

Neni 15

Pasardhësit ligjorë ose ekonomikë të ndërmarrjes të gjobitur nga Autoriteti

1. Në rastet kur brenda një ndërmarrjeje që ka marrë pjesë në një shkelje të ligjit ka ndryshime ligjore ose organizative, Autoriteti mund të shqiptojë gjobë ndaj pasardhësit ligjor ose ekonomik të ndërmarrjes.
2. Autoriteti do të përcaktojë masën në të cilën gjobat e shqiptuara nga Autoriteti nuk janë paguar nga ndërmarrja, të drejtat ose veprimtaria ekonomike të së cilës janë marrë përsipër, si dhe cilët janë trashëguesit (pasardhësit) e të drejtave ose të veprimtarisë ekonomike të kësaj ndërmarrjeje.

Neni 16

Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ

Ndryshimi dhe plotësimi i këtij Udhëzimi Administrativ mund të propozohet nga çdo anëtar i Komisionit dhe bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e saj.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kryetarja

Neime Binaku - Isufi
